

## STATUT

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR

#### K A P I T U L L I   I

**KRIJIMI; FORMA; OBJEKTI ; KOHËZGJATJA; EMËRTIMI; SELIA**

#### N E N I \_ 1

##### **KRIJIMI I SHOQËRISË**

Shoqeria “AH MEDICAL CONSULTING “ sh.p.k Mbeshtetur ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare “, hartuan kete statut te ri te ndryshuar te shoqerise me perjegjesi te kufizuar me emertimin “AH MEDICAL CONSULTING” Sh.p.k

Shoqeria eshte person juridik shqiptar e pershtatur ne perputhje me kerkesat ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare “.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjisacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese (Akt Themelimi dhe Statut).

#### N E N I \_ 2

##### **FORMA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me perjegjesi te kufizuar , për sa kohë që Ortaket e kesaj shoqerie nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj në një shoqëri anonyme.

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregetaret dhe Shoqëritë Tregtare”.

#### N E N I \_ 3 **EMËRTIMI**

Emërtimi i shkurtër i shoqërisë është “AH MEDICAL CONSULTING” sh.p.k . Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Pergjegjesi te Kufizuar” ose inicialet sh.p.k .



## N E N I \_ 4

### **SELIA**

Shoqëria e ka selinë ne qytetin e Lushnjes , ne adresen:" Fier; LUSHNJE; Lushnje; ; LUSHNJE; Lagjja Xhevdet Nepravishta, rruga Rahman Ruçi"

Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Ortakeve te kesaj shoqerie .

## N E N I \_ 5 **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, por jo më pak se 10 vjet, duke filluar që nga data e regjistrimit të saj në Q K B, Lushnje.

Në përputhje më këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

## N E N I \_ 6

### **OBJEKTI**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "**AH MEDICAL CONSULTING**" sh.p.k do të shtrihet në këto fusha veprimi:

.KAPITULLI II

### **KAPITALI THEMELTAR; KUATAT DHE KALIMI I KUATAVE**

## N E N I \_ 7 **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali eshte fiksuar ne lek 100.000 (njëqindmije) leke.

Kapitali ndahet në 1 ( nje ) kuote me vlore 100.000 (njeqinde mijë) lekë , të numëruara ne 1 (një) të shlyera në masën 100%

nga , Ortaku themelues ne raporte me zoterimin e kapitalit themeltar . Ai mund te zmadhohet dhe te zvogelohet me vendim te Ortakeve sipas normave te fushes ne fuqi.



## **NENI – 7/1**

### **KUOTAT**

Kuotat e pjesëmarrjes janë ne zotrim të :

1. **ASFLORAL HAXHIU**, dhe perqindja e pjesmarrjes 100%

## **N E N I 8**

### **MENYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- Shitblerjes;
- Trashegimise;
- Dhurimit;
- Cdo menyre tjeter parashikuar ne ligj.

## **N E N I 9**

### **PASOJAT E KALIMIT TE KUOTAVE ,PJESTIMI DHE TRANSFERIMI I TYRE**

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e perfiton ate perjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes , nga casti i kalimit te kuatave , deri ne castin e regjistrimit te kalimit , sipas pikes 2 te ketij nenii .

Shoqeria realizon kalimin e kuotes , sipas nenit 43 te ligjit nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” .

Me perjashtim te rasteve kur kjo eshte e ndaluar nga statuti , kuotat mund te pjestohen per shkak te kalimit te tyre .

Nese nje prej ortakeve ( ortaku shites ) ka si qellim ti transferoj te treteve , tersisht apo pjeserisht kuotat e shoqerise ne pronesi te tij ( ne vijim kuotat e ofruara)duhet qe paraprakisht , sipas te drejes se parablerjes , tia ofroj keto kuota ortakeve te tjere , nepermjet nje njoftimi me shkrim i cili duhet te permbaje emrin dhe te dhenat e blersit , numrin e kuotave qe ka si qellim te shese , cmimin e shitjes dhe cdo afat apo kusht tjeter per transferimin .



Nese ortaket e tjere kane si qellim te ushtrojne te drejten e parablerjes sikurse percaktohet ne paragrafin e mesiper ( ne vijim e drejta e parablerjes ) duhet te njoftojne ortakun shites ( ne vijim pranim i parablerjes), permes nje njftimi i cili duhet te dergohet brenda dhe jo me vone se 30 dite pune nga data e marrjes se njoftimit te parablerjes .Ne pranimin e parablerjes duhet te tregohet vullneti i pakushtezuar per blerjen e te gjitha kuotave te ofruara me te njejtat kushte per te cilat eshte rene dakort me palen e trete blerese .

Transferimi i kuotave te ofruara dhe pagesa e cmimit duhet te kryhen njekohesisht dhe brenda dites se 20-te te punes vijuese te mbarimit te afatit prej 30 diteve pune te percaktuara mesiper .

Nese ortaket e tjere nuk ushtrojne te drejten e parablerjes sipas afateve te percaktuara me lart,ortaku shites eshte i lire qe kuotat e ofruara tia shese te treteve , ne perputhje me cmimin,afatet dhe kushtet e percaktuara ne njoftimin e parablerjes , brenda 30-diteve pune nga mbarimi i afatit te percaktuar ne paragrafin e mesiper .

Dispozitat e nenit 9 per kalimin e kuotave zbatohen edhe per kalimin e pjeseve te kuotave .

### **KAPITULLI III**

#### **MARRDHENIET NDERMJET SHOQERISE DHE ORTAKEVE**

##### **NENI 10**

##### **SHPERNDARJA E FITIMEVE**

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut , ortaket kane te drejte te ndajne pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise .

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut , fitimi u shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteraura .

##### **NENI 11**

##### **KUFIZIMET E SHPERNDARJES , CERTIFIKATA E AFTESISE PAGUESE, PERGJEGJESITE**



Shoqeria mund tu shperndaj fitim ortakeve , vetem nese pas pagimit te dividentit:

- Aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj;
- Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12-muajve ne vazhdim.

Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese , e cila konfirmon shprehimi i se shperndarja e propozuar e dividenteve e permbug kerkesat e paragrafit te pare te ketij neni , ndersa kur gjendja e shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividenteve nuk i permbug keto kriteri, administratoret nuk munt te leshojne kete certifikate .

Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese .

Administratoret te cilet nga pakujdesia leshojne nje certifikate te pasakte te aftesise paguese , pergjigjen personalisht perpara shoqerise per kthimin e dividenteve te shperndare .

Ortaket , qe kane mare nga shoqeria divident , pergjigjen personalisht ndaj shoqerise per kthimin e dividenteve , pavarsisht leshimit te certifikates , keta ortake kane pasur dijeni per gjendjen e paaftesise paguese te shoqerise sipas paragrafit te pare te ketij neni .

## **KAPITULLI IV**

### **ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

**1. Asambleja e Pergjithshme**

**2. Administratoret .**

### **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

#### **N E N I 12**

#### **TE DREJTAT DHE DETYRAT**

Asambleja e Pergjithshme eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :



- a) Percaktimin e politikave tregetare te Shoqerise;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve;
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c dhe c, te kesaj pike
- f) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret , perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise ;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise ;
- h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) Pjestimin e kuatave dhe anulimin e tyre ;
- j) Perfaqsimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve ;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise ;
- l) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Nese shoqeria zoterohet nga nje ortak i vetem , te drejtat dhe detyrimet e asamblese se per gjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem .Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve , te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhen regjistruar ne vecanti , por pa u kufizuar ne to , vendimet per:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve ;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise .

Vendimet e paregjistraura ne regjistrin e vendimeve jane apsolusht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund ti kundrejtoje pavlefshmerine te tretit , qe ka fituar te drejta ne mirebesim , pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine , apo ne baze te rr Ethanave te qarta nuk mund te kishte pasur dijeni per te .

## N E N I 13

### MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.



3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
- 
7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
  8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

#### N E N I 14

#### MENYRA E THIRRJES

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### N E N I 15




## KERKESAT NGA ORTAKET E PAKICES

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.
2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
  - a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
  - b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.
3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të këtij ligji.
4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjera të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

## N E N I 16

### PERFAQSIMI NE ASAMBLE

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



## N E N I \_ 17

### KUORUMI

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë pér çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet pér shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në pikën 1 të këtij nenit, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## N E N I \_ 18

### MARRJA E VENDIMEVE

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, pér ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në (paragrafin 18.4), pér çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

4. Vendimet e asamblesë se përgjithshme ne lidhje ne sa me poshte ,merren vlefshmerisht me voten pro te ortakeve qe perfasojne te pakten shumicen e zakonshme.

- Miratimi i bilancit.
- Shperndarja e dividenteve.
- Emerimi dhe / ose shkarkimi i administratoreve dhe ekspertit kontabel dhe percaktimi i shperblimit te tyre .
- Emerimi dhe shkarkimi i personit qe do te merret me kontabilitetin e shoqerise .



- Miratimmi i buxhetit vjetor.
- Autorizimin per nenshkrimin e cfardolloj kontrate.
- Miratimi i kerkeses per perjashtimin e njerit prej ortakeve .
- Ndryshimet e statutit.
- Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.
- Perfaqsimi i shoqerise ne gjykate.
- Riorganizimi dhe prishja e shoqerise .

## **N E N I 19**

### **E DREJTA E VOTES**

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

2. Statuti mund të parashikojë për ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;

b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;

c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

5. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky ligj apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

## **N E N I 20**

## PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## N E N I \_ 21

### PROCESVERBALET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

2. Procesverbali duhet të përmbarjë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

3. Prosesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

4. Prosesverbali i mbledhjes nënshkrum me kryetarin e mbajtësinë i procesverbalit.

5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

## N E N I \_ 22

### HETIMET E POSACME



1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.
2. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kérkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kérkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kérkesës, kérkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.
3. Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij nenit mund t'i kérkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.
4. Kur gjykata pranon kérkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij nenit, shoqëria tregtare përballon kostot e emëritit dhe të shpérblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.
5. E drejta për të kérkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.
6. Kreditori, që në keqbesim paraqet një kérkesë, sipas pikës 2 të këtij nenit, përgjigjet në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

#### NENI 23

#### SHFUQIZIMI I VENDIMEVE TE PARREGULLTA DHE DEMSHPERBLIMI

1. Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kérkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit.
2. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, ose një vlerë më të vogël të parashikuar në statut, apo secili prej kreditorëve të shoqërisë mund t'i kérkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtpërdrejt përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kérkesës, kérkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.



3. Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme.

4. Ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e përgjithshme mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.

5. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçëm për korrigjin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacenuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji.

6. Ortakët në pakicë dhe kreditorët e përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur asambleja e përgjithshme nuk merr vendim, ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre për ngritjen ndaj administratorëve të padisë, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si vendim i paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

7. Dispozita e paragrafit të gjashtë të nenit 91 të këtij ligji zbatohet edhe për këto padi.

#### N E N I 24


#### TE DREJTAT E LIDHURA ME KUOTEN

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

#### N E N I 25

#### NDALIMI I KUFIZIMEVE

1. Janë të pavlefshme dispozitat e statutit, që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e ortakëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 91, 92 e 93 të këtij ligji, si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve të përcaktuara në këto nene.



2. Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të cenojnë të drejtën e ortakëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 91, 92 e 93 të këtij ligji.

## ADMINISTRATORËT

### N E N I \_ 26

#### EMERIMI, SHKARKIMI, TE DREJTAT DHE DETYRIMET

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, eshte me një afat prej 5 (pese) vitesh, me të

drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme më rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicën e parashikuar ne nenin 18/4. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administrator i shoqerise eshte : **ASFLORAL HAXHIU**

## N E N I 27

### PERFAQSIMI

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji.

2. Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.

3. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

4. Administratoret mund te nenshkruajne kontrata vetem pasi te jene miratuar nga asambleja e përgjithshme .

## N E N I 28



## SHPERBLIMI

1. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme.
2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij nenit, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.
3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.
4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

## N E N I 29

### DETYRIMI I BESNIKERISE DHE PERGJEGJESIA

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, administratorët detyrohen:
  - a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;
  - b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;
  - dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.



3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) japid kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të këtij ligji zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

## TITULLI V

### PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

#### KREU I

PRISHJA E SHOQËRISË

N E N I    30

#### SHKAQET E PRISHJES SE SHOQERISE

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;



- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsyet e tjera, të parashikuara në statut.

### N E N I 31

#### REGJISTRIMI I SHPERBERJES

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim.

#### KREU II

#### LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

### N E N I 32

#### LARGIMI I ORTAKUT PER SHKAQE TE ARSYESHME

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjera ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.
2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.
3. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njofimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij nenit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

4. Ortaku ka të drejtë të ngrëjë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk ? njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.
5. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpérblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.
6. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrëjë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpérblimin e dëmit të pësuar.

## **N E N I  33**

### **PERJASHTIMI I ORTAKUT**

1. Asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.
2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij nenit, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku:
  - a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
  - b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
  - c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
  - ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.
3. Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.
4. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpérblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.
5. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpérblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.



6. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

### N E N I 34

#### PASOJAT E LARGIMIT DHE PERJASHTIMIT

1. Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.
2. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

### N E N I 35

#### LIKUJDIMI NE GJENDJEN E AFTESISE PAGUESE

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij ligji.

Lushnje , me /03/2021

23. 3.2021

ORTAKU I VETEM  
ASFLORAL HAXHIU  
*Asfloral Haxhiu*

